

AKT THEMELIMI DHE STATUTI “D.G. GROUP AL” SH.P.K.

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“D.G. GROUP AL” SH.P.K.**

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“D.G. GROUP AL” SH.P. K**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA**

**NENI 1
DATA E THEMELIT, THEMELUESIT, EMRI I SHOQËRISË**

Sot në datën 14.09.2022 është krijuar shoqëria me emërtimin “D.G. GROUP AL” SH.P.K. me ortakë:

1.1 Luçiano Luçi, i datëlindjes 24.11.1991, lindur në Vlorë, dhe banues në Vlorë, “Lagjia Hajro Cakëri, Rruga Thanas Floqi nr. 16, 9402”, me nr. personal J11124069T.

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

- 2.1 Call Center, Telemarketing, Teleshitje, Shërbime konsulence, Hapje faqe Website.
- 2.2 Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregtar importi, eksporti, tregti me shumicë e pakicë të mallrave, çdo aktivitet që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, dhënien me qira të apartamenteve, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, leasing e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri.
- 2.3 Shoqëria mund të kryejë aktivitet publikimi dhe reklamimi.
- 2.4 Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër siç mund të konsiderohet i nevojshëm apo i dobishëm apo ndihmës në përmbushjen e qëllimeve të mësipërme.
- 2.5 Të japë me qira ose në pronësi llojet e instalimeve që kanë në zotërim dhe që i shërbejnë veprimtarisë së saj kurdoherë dhe kudo që gjenden. Të themelojë dhe/ose të bëhet bashkëpjesëtarë në çfarëdolloj ndërmarrje në Shqipëri ose jashtë shtetit, me të njëjtin qëllim apo të përafërt që funksionon në çdo formë ligjore.
- 2.6 Dhënie me qira e makinave, mjeteve lundruese dhe dhoma plazhi, biletari etj...
- 2.7 Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria shpk mund të bëjë ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke bërë ndryshimet përkatëse në statutin e shoqërisë.

**NENI 3
SELIA**

Shoqëria “D.G. GROUP AL” SH.P.K. e ka selinë e saj në Vlorë, “Lagjia Hajro Cakëri, Rruga Sulejman Delvina, pranë me Universitetin Ismail Qemali - Fakulteti i Shkencave Humane, Kodi postar 9402”.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda e jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare si dhe ti suprimojë ato.

**NENI 4
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë “D.G. GROUP AL” SH.P.K. është me afat të pakufizuar.

KREU II
KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 5
KAPITALI I REGJISTRUAR
VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TË REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 10.000 lekë të reja, i ndarë në 1 (një) pjesë me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë secila. Pjesëmarrja e themeluesëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

- 5.1 Luçiano Luçi, zotëron 1 (një) pjesë të kapitalit, ose 100% të tij, të barabartë me 10.000 lekë të reja (dhjetë mijë). Kapitali do të derdhet pjesë-pjesë në varësi të nevojave financiare të shoqërisë. Modalitetet e derdhjes së kapitalit përcaktohen nga administratori i shoqërisë.

NENI 6
TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

Ortakët gëzojnë këto të drejta e detyra themelore:

- të derdhin kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 5;
- të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë;
- të tërheqin fitimin e realizuar;
- të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë;
- të impenjohen në arritjen e objektivave të shoqërisë;
- të tërheqin aktivin rezultat nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë.

NENI 7
KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

- 7.1 Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera. Kuotat të tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 ditësh të plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara, personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë të kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- 7.2 Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë dhe përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve sipas njoftimit të mësipërm.
- 7.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
- 7.4 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendet ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- 7.5 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet midis ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.
- 7.6 Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë, por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës, së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute para anulimit të kuotës.

NENI 8

LLOJET E KUOTAVE, TË DRJETAVE DHE KUFIZIMEVE

Kuotat mund të emërtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve.

NENI 9

CERTIFIKATAT E KUOTAVE

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

NENI 10

KALIMI ME KONTRATË I KUOTAVE

- 10.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formalit të vetëpërcaktuar nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
- 10.2 Administratorët mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratorët nuk janë dakord me personin të cilit i kalon kuota.
- 10.3 Nëse Administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

NENI 11

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

- 11.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues të së drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk lirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 11.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të ortakut, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës, ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje.
- 11.3 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

NENI 12

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë dhe kapitalin themeltar të shoqërisë, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- 12.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

KREU III **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

NENI 13 **THIRRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

- 13.1 Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesë të ortakëve.
- 13.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë dhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet shtatë ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen.
- 13.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme të njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

NENI 14 **MBLEDHJET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.2 Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si dhe një person që të mbajë procesverbalin e saj.
- 14.3 Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- 14.4 Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.5 Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohet vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- 14.6 Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga: *kryetari*; ose një *ortak* ose *ortakët* që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.
- 14.7 Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi i miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatë në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 14.8 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër votimit.

NENI 15 VOTAT E ORTAKËVE

- 15.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 15.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- 15.3 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

NENI 16 HETIMET E POSAÇME

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të Fushës paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

NENI 17 EMËRIMI I ADMINISTRATORËVE

Asambleja e Përgjithshme ka emëruar Administrator të shoqërisë Luçiano Luçi, mandati i të cilit fillon me datën 14.09.2022 dhe do të vazhdojë për pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 18 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

- 18.1 Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.2 Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

NENI 19 SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORËVE

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- personi nuk është më Administrator kur asambleja e përgjithshme ka vendosur shkarkimin e tij;
- personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
- ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

NENI 20

SHPËRBLIMI, PËRFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATORËVE

Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme. Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimet e tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

NENI 21

MBLEDHJET E ADMINISTRATORËVE

- 21.1 Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- 21.2 Vendimet e mbledhjes së Administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga Administratorët, dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar ai do të jetë dy.
- 21.3 Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- 21.4 Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
- 21.5 Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

NENI 22

KUFIZIMET NË VOTIMET E ADMINISTRATORËVE

- 22.1 Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose të votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
- të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshjeje dhe
 - të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
- 22.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 22.3 Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.
- 22.4 Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund t'i drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

NENI 23
PROCESVERBALET E MBLEDHJEVE TE ADMINISTRATORËVE

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

- të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët dhe,
- të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

NENI 24
DIVIDENDËT

- 24.1 Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 24.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 24.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- 24.4 Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

NENI 25
KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KREU IV
KONTROLLI KONTABËL I SHOQËRISË
VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 26
KONTROLLI KONTABËL

Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 27
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 28
BILANCI DHE REZERVAT

Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratorët marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortakët të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Ortakët në çdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

NENI 29
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

NENI 30
NJOFTIMET

Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 13 të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin. Ky Statut, së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë.

NENI 31
LIGJI I ZBATUESHËM

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelim dhe Statutin e shoqërisë, si dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar përkatës në fuqi. Ky Akt hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortakët themelues, firmoset si më poshtë prej tyre.

VLORE MË 14.09.2022
EMRI DHE NËNSHKRIMI I ORTAKUT THEMELUES:
“D.G. GROUP AL” SH.P.K.
Përfaqësuar nga:

LUÇIANO LUÇI

NENI 32
ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet e shoqërisë “D.G. Group AL” SH.P.K. Janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.
Administrator i shoqërisë do të jetë zoti Luçiano Luçi, mandati i të cilit fillon më datën 11.09.2022
e do të vazhdojë për pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Ky dokument është përpiluar në katër kopje.

THEMELUESI
LUÇIANO LUÇI